



Komisioni Qendror i Zgjedhjeve • Centralna Izborna Komisija • Central Election Commission
Republika e Kosovës • Republika Kosova • Republic of Kosova

KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE, në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 59, 63 dhe 64 të Ligjit Nr.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, nenin 21 të Rregullores së Punës së KQZ, në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datën 30.01.2025, nxjerr këtë:

VENDIM

Për Miratimin Pjesëmarrjes së KQZ-së në Takimin "Konferenca e 20-të Evropiane e Organeve të Menaxhimit Zgjedhor "Stabiliteti i Ligjit Zgjedhor - Aspekte Praktike"

- I. Miratohet pjesëmarrja e KQZ-së në takimin "Konferenca e 20-të Evropiane e Organeve të Menaxhimit Zgjedhor "Stabiliteti i Ligjit Zgjedhor - Aspekte Praktike".
- II. Konferenca do të mbahet në Akademinë e Shkencave të Lituanisë, në Vilnius më datën 15 dhe 16 prill 2025.
- III. Pjesëmarrës në këtë konferencë janë:
 - 1.Kreshnik Radoniqi
 - 2.Alban Krasniqi
 - 3.Besnik Buzhala
- IV. Obligohet Sekretariati i KQZ-së, për zbatimin e këtij vendimi.
- V. Ky vendim, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Prishtinë, 30.01.2025





Komisioni Qendror i Zgjedhjeve • Centralna Izborna Komisija • Central Election Commission
Republika e Kosovës • Republika Kosova • Republic of Kosova

KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE, në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 63, 64 paragrafi 2.10 nenin 77 dhe nenin 79 të Ligjit Nr.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, nenin 7 paragrafi 3 të Rregullores Zgjedhore Nr.11/2024 Këshillat e Vendvotimeve, vendimin e KQZ-së, Nr.01/84-2025, të datës 14.01.2025, për Përbërjen e Këshillave të Vendvotimeve të Rregullta dhe me Kusht, si dhe vendimin e KQZ-së Nr.01/85-2025 të datës 14.01.2025, për Përbërjen e Ekipeve të Numërimit në QKN-së, për zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës 2025, në mbledhjen e rregullt të mbajtur më datë 30.01.2025, nxjerr këtë:

VENDIM

Për Emërimin e Këshillave të Vendvotimeve (KVV) në Vendvotimet e Rregullta dhe me Kusht, si dhe Ekipeve të Numërimit në QKN

- I. Emërohen Këshillat e Vendvotimeve (KVV) në Vendvotimet e Rregullta dhe me Kusht, si dhe Ekipeve të Numërimit në QKN për zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më 9 shkurt 2025, për komunat:

Deçan, Gjakovë, Glogoc, Gjilan, Dragash, Istog, Kaçanik, Klinë, Fushë Kosovë, Kamenicë, Mitrovicë e Jugut, Leposaviq, Lipjan, Novobërdë, Obiliq, Rahovec, Pejë, Podujevë, Prishtinë, Prizren, Skenderaj, Shtime, Shtërpcë, Suharekë, Ferizaj, Viti, Vushtrri, Zubin Potok, Zveçan, Malishevë, Junik, Mamushë, Hani Elezit, Graçnicë, Ranillug, Partesh, Klllokot dhe Mitrovicë e Veriut.

- II. Regjistri i anëtarëve si në pikën I dhe II, është pjesë përbërëse e këtij vendimi.
- III. Obligohet Sekretariati i KQZ-së, për zbatimin e këtij vendimi.
- IV. Ky vendim, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Prishtinë, 30.01.2025

Kreshnik RADONIQI
Kryesues i KQZ
Republika e Kosovës
Republika Kosova
Prishtinë
Priština
CENTRALNA IZBORNA KOMISIJA



Komisioni Qendror i Zgjedhjeve • Centralna Izborna Komisija • Central Election Commission
Republika e Kosovës • Republika Kosova • Republic of Kosova

KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE, në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 63, 64 paragrafi 2.10, nenin 77 paragrafi 11, nenin 77 dhe nenin 79 të Ligjit Nr.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, nenin 7 të Rregullores Zgjedhore Nr.11/2024 Këshillat e Vendvotimeve, neni 12 paragrafi 7 të Rregullores Zgjedhore Nr.17/2024, Regjistrimi dhe Votimi Jashtë Kosovës, si dhe vendimin e KQZ-së, Nr.01/192-2025, të datës 21.01.2025, për Miratimin e Përbërjes së Këshillave të Vendvotimeve në Vendvotimet në Përfaqësitë Diplomatike për Zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës 2025, në mbledhjen e rregullt të mbajtur më datë 30.01.2025, nxjerr këtë:

VENDIM

Për Emërimin e Këshillave të Vendvotimeve (KVV) në Vendvotimet në Përfaqësitë Diplomatike

- I. Emërohen e Këshillat e Vendvotimeve (KVV) në Vendvotimet në Përfaqësitë Diplomatike për zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen në këto Përfaqësi Diplomatike më 08 shkurt 2025.
- II. Regjistri i anëtarëve të KVV-ve si në pikën I, është pjesë përbërëse e këtij vendimi.
- III. Obligohet Sekretariati i KQZ-së, për zbatimin e këtij vendimi.
- IV. Ky vendim, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Prishtinë, 30.01.2025

Kreshnik RADONIQI

Kryesuesi KQZ





Komisioni Qendror i Zgjedhjeve • Centralna Izborna Komisija • Central Election Commission
Republika e Kosovës • Republika Kosova • Republic of Kosova

KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE, në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 59 paragrafi 2, nenin 63 dhe nenin 113 të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datën 30.01.2025, nxjerr këtë:

VENDIM

Për Miratimin e Raportit të Shpenzimeve të Derivateve për Veturat e KQZ për Vitin 2024

- I. Miratohet Raporti i shpenzimeve të derivateve për veturat e KQZ, për periudhën janar- dhjetor 2024.
- II. Raporti si në pikën I, është pjesë përbërëse e këtij vendimi.
- III. Obligohet Sekretariati i KQZ-së, për zbatimin e këtij vendimi.
- IV. Ky vendim, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Prishtinë, 30.01.2025

Kreshnik RADONIQI

Kryesues i KQZ



Komisioni Qendror i Zgjedhjeve • Centralna Izborna Komisija • Central Election Commission
Republika e Kosovës • Republika Kosova • Republic of Kosova

KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE, në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 63, si dhe nenin 83 të Ligjit Nr.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, si dhe nenin 2 të Rregullores Zgjedhore Nr.5/2024, Themelimi dhe Menaxhimi i Qendrave të Votimit, në mbledhjen e rregullt të mbajtur më datën 30.01.2025, nxjerr këtë:

VENDIM

Për Miratimin e Rekomandimit për Ndryshimin e Lokacionit të Qendrës së Votimit (QV) në Lepasaviq

- I. Miratohet rekomandimi i Kryesuarit të Komisionit Komunal të Zgjedhjeve (KKZ) në Lepasaviq, për ndryshimin e lokacionit të Qendrës së Votimit, si në vijim:
 1. Votuesit e Qendrës së Votimit 1211 në fshatin Borqan zhvendosen në objektin e departamentit të avancuar të shkollës fillore “Vuk Karagjiq” në Soqanicë të Epërme.
 2. Votuesit e Qendrës së Votimit 1207 në fshatin Koshutovë zhvendosen në Qendrën e Votimit të vendosur në objekt privat në pronësi të Asllan Hasanit.
 3. Votuesit e Qendrës së Votimit 1210, e cila ndodhet në objektin privat “Lovacki Dom Bistrica”, zhvendosen në Qendrën e Votimit 1213, që gjendet në objektin e Zyrës Lokale për Komunitete në Jarinjë të Poshtme.
- II. Rekomandimi si në pikën I, është pjesë përbërëse e këtij vendimi.
- III. Obligohet Sekretariati i KQZ-së, për zbatimin e këtij vendimi.
- IV. Ky vendim, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Prishtinë, 30.01.2025





Komisioni Qendror i Zgjedhjeve • Centralna Izborna Komisija
Republika e Kosovës • Republika Kosova • Republic of Kosova

KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE, në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 63, nenin 64 dhe neni 101, paragrafi 17 të Ligjit Nr.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, në mbledhjen e rregullt të mbajtur më datën 30.01.2025, nxjerr këtë:

VENDIM

Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Projektit për Transparencën në Qendrat Komunale të Numërimit i Miratuar me Vendimin e datës 28.10.2024, Nr.01/1886/2024

- I. Miratohet ndryshimi dhe plotësimi i Projektit për Transparencën në Qendrat Komunale të Numërimit, i miratuar me vendimin e datës 28.10.2024, Nr.01/1886/2024.
- II. Projekti i ndryshuar dhe plotësuar si në pikën I, është pjesë përbërëse e këtij vendimi.
- III. Obligohet Sekretariati i KQZ-së, për zbatimin e këtij vendimi.
- IV. Ky vendim, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Prishtinë, 30.01.2025

Kreshnik RADONIQI
Kryesues i KQZ



Komisioni Qendror i Zgjedhjeve • Centralna Izborna Komisija • Central Election Commission
Republika e Kosovës • Republika Kosova • Republic of Kosova

KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE, në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 59 paragrafi 2, nenin 63 dhe nenin 113 të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datën 30.01.2025, nxjerr këtë:

VENDIM

Për Miratimin e Raportit Vjetor Financiar të KQZ për vitin 2024

- I. Miratohet Raporti vjetor financiar i KQZ, për periudhën janar- dhjetor 2024.
- II. Raporti si në pikën I, është pjesë përbërëse e këtij vendimi.
- III. Obligohet Sekretariati i KQZ-së, për zbatimin e këtij vendimi.
- IV. Ky vendim, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Prishtinë, 30.01.2025

Kreshnik RADONIQI
Kryesues i KQZ